



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Qeveria - Vlada - Government**

*Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister*

*Zyra për Qeverisje të Mirë / Kancelarija za Dobro Upravljanje / Office of Good Governance*

# **Kornizë për përmirësimin e zbatimit të standardeve minimale për konsultimet publike 2021-2025**

*Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër  
të Zyrës së Kryeministrit*

*(Publikimi i kësaj kornize u mundësua me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë. Përmbajtja dhe mendimet e shprehura në të nuk reflektojnë medoemos qëndrimin zyrtar të Misionit të OSBE-së në Kosovë.)*



# **Kornizë për përmirësimin e zbatimit të standardeve minimale për konsultimet publike 2021-2025**

*Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër  
të Zyrës së Kryeministrit*

Shtator 2021

## PËRMBAJTJA:

### Informata të përgjithshme..... 9

**Konsultimet publike, Integrimi Evropian dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm..... 9**

**Progresi me konsultimet publike deri në vitin 2020 ..... 10**

**Performanca e konsultimeve 2017-2020..... 11**

**Sfidat me konsultimet publike ..... 12**

**Rekomandime për përmirësimin e konsultimit publik ..... 14**

### Identifikimi i rekomandimeve përmes punëtorive të synuara të konsultimit ..... 15

### Qëndrueshmëria e mbështetjes politike: zgjerimi i thirrjes së konsultimit publik në nivelin qendror dhe lokal ..... 16

**Rekomandimi 1:** Në vitin 2021, ZQM duhet të organizojë një konferencë të nivelit qendror me përfshirje politike të nivelit të lartë që mbulon gjerësisht konsultimin publik. Kjo konferencë mund të përfshijë edhe tema të tjera që kanë të bëjnë me qeverisjen e mirë. Fokusi i një konference të tillë duhet të jetë në vlerën e shtuar të procesit të konsultimit për vendimmarrjen politike ..... 17

**Rekomandimi 2:** Pas konferencës më 2021, ZQM duhet të vlerësojë se si të sigurojë një angazhim të vazhdueshëm të nivelit politik. Kjo mund të jetë duke vazhduar konferencën për konsultime publike/ qeverisje të mirë në një plan dyvjeçar duke organizuar ngjarje të dedikuara në vitin e ndërmjetëm ..... 17

### Përmirësimi i funksionalizimit të platformës online të konsultimeve..... 17

**Takime publike në internet: veçori e re e platformës ..... 17**

**Rekomandimi 3:** ZQM duhet të konsiderojë integrimin e përdorimit të takimeve në internet ose atyre të kombinuara si tipar standard në procesin e konsultimit për të nxitur pjesëmarrjen duke ulur pragjet e pjesëmarrjes. Takimi zyrtar publik në fillim të procesit të vendimmarrjes mund të organizohet gjithmonë si takim i kombinuar ..... 18

**Rekomandimi 4:** ZQM duhet të konsiderojë rregullimin e platformës në internet të konsultimit për t'i mundësuar njerëzve që të regjistrohen për takime dhe të marrin automatikisht informacion për t'u bashkuar në takimin në internet. Kjo do ta bënte më të lehtë pjesëmarrjen dhe gjithashtu më lehtë për ministrinë që ta menaxhojnë organizimin e takimit. .... 18

**Qasja për personat me aftësi të kufizuara dhe respektimi i Direktivës së BE-së për Qasje në Ueb..... 18**

**Rekomandimi 5:** ZQM duhet të integrojë tipare në platformën e konsultimeve në internet në vitin 2021 të cilat rrisin mundësinë e qasjes për personat me aftësi të kufizuara ..... 20

**Rekomandimi 6:** Gjatë rishikimit të arkitekturës bazike të platformës së konsultimit në internet, ZQM duhet të sigurojë zbatim të plotë të Direktivës së BE për Qasje në Ueb dhe

t'i integrojë tiparet më të fundit që mundësojnë qasje të plotë për personat me aftësi të kufizuara ..... 20

### **Dorëzimi i komenteve për përdoruesit..... 20**

**Rekomandimi 7:** ZQM duhet të vlerësojë mundësitë më të fundit për thjeshtëzimin e angazhimit të qytetarëve dhe duhet të shqyrtojë se cilat tipare mund të zbatohen përmes platformës së konsultimeve në internet. .... 21

**Rekomandimi 8:** ZQM duhet të vlerësojë nisma të tilla si 'Citizens OS' dhe duhet të angazhohet drejtpërdrejt me ekspertët kryesorë nga nisma të tilla përmes punëtorive gjegjëse dhe vizitave..... 21

**Rekomandimi 9:** ZQM duhet të vlerësojë cilësinë e platformave të konsultimit publik në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe duhet të vlerësojë se cilat praktika më të mira mund të zbatohen në Kosovë. Organizimi i shkëmbimeve duhet të parë në këtë kontekst. .... 22

### **Konsultimet e bazuara në aplikacione ..... 22**

**Rekomandimi 10:** Kur të ridizajnohet Platforma e konsultimeve në internet, ZQM duhet të vlerësojë mundësinë për të zhvilluar një version të aplikacionit të uebfaqes që mundëson pjesëmarrje më të lehtë përmes telefonave të mençur ..... 22

### **Përgjigja nen për nen ..... 22**

**Rekomandimi 11:** ZQM duhet të vlerësojë mundësinë për t'u mundësuar pjesëmarrësve në konsultim që të japin komente nen për nen. Kjo do ta bënte pjesëmarrjen më të lehtë dhe do ta thjeshtonte raportimin për administratën..... 23

### **Përgjigja në kohë reale ..... 23**

**Rekomandimi 12:** ZQM duhet të përcaktojë kushtin që administratat të japin përgjigje/ informata kthyesë menjëherë kurdoherë që është e mundshme, ndërsa procesi i konsultimit publik është duke vazhduar në platformën në internet kur të futet mundësia e përgjigjes nen për nen ..... 23

### **Grupet e punës të publikuara në platformën e konsultimit në internet..... 23**

**Rekomandimi 13:** ZQM duhet të marrë parasysh obligimin që ministritë e linjës duhet të publikojnë vendimet për grupet e punës të krijuara të cilat janë përgjegjëse për zhvillimin e ligjeve, akteve nënligjore, strategjive, koncept dokumenteve, etj., ashtu që palët e interesuara duhet të jenë në gjendje që të paraqesin brenda dy javësh një propozim të arsyetuar për atë se pse ata e konsiderojnë se është e rëndësishme që të ftohen si anëtarë aktivë të një grupi të tillë pune. Palët e interesit duhet të jenë në gjendje në çdo moment të dhënë që të tregojnë se ata do të donin të angazhoheshin me anëtarët e grupit të punës për t'iu dëgjuar zëri i tyre ..... 24

### **Raportimi për konsultimet publike..... 24**

**Rekomandimi 14:** ZQM duhet të rivlerësojë kërkesat për raportim dhe duhet të përcaktojë se çfarë raporte dhe cilat të dhëna duhet të sigurohen nga ministritë e linjës ..... 25

**Rekomandimi 15:** Kur të ridizajnohet platforma e konsultimeve në internet, ZQM duhet të sigurojë që raportimi të bëhet në versionin e automatizuar sa më shumë që është e mundshme. Kjo i lejon administratës që të përqendrohet më shumë në përmbajtjen e konsultimit publik ..... 25

### **Integrimi i të gjitha hapave të hartimit të legjislacionit dhe vendimmarrjes së qeverisë..... 25**

**Rekomandimi 16:** ZQM duhet - në bashkëpunim me Zyrën Ligjore, Zyrën e Planifikimit Strategjik, Sekretarinë Mbështetëse të Qeverisë, Zyrën e Komisionarit për Gjuhë dhe organizata të tjera përkatëse, të vlerësojnë mundësinë për të zhvilluar një platformë

digjitale që integron të gjitha kërkesat e vendimmarrjes. Sistemi TI mund të integrojë parakushtet, p.sh., që procesi i miratimit nuk mund të fillojë nëse nuk janë zhvilluar aktivitetet minimale të këshillimit të detyrueshëm. Platforma e konsultimeve në internet duhet të jetë një element i plotë në një sistem të tillë të TI..... 26

#### **Qasja në TI për koordinatorët për konsultim publik ..... 26**

**Rekomandimi 17:** ZQM duhet të nxisë zhvillimin e një zgjidhjeje në mënyrë që të gjithë koordinatorët për konsultimin publik në ministrinë e linjës të kenë qasje të plotë në platformën e konsultimit në internet nga vendet e tyre të punës ..... 27

**Rekomandimi 18:** ZQM duhet të kontrollojë nëse koordinatorët për konsultim publik në nivelin lokal gjithmonë kanë qasje në platformën e konsultimit në internet për të shmangur probleme të ngjashme që janë të pranishme në nivelin qendror..... 27

### **Vizibiliteti i platformës së konsultimeve në internet ..... 27**

#### **Krijimi i platformës së konsultimeve në internet si kanal i vetëm për dhënien e kontributit për palët e interesuara ..... 27**

**Rekomandimi 19:** ZQM duhet të organizojë takime në nivelin qendror me ministrinë e linjës dhe OSHC-të për të inkurajuar përdorimin e platformës së konsultimeve në internet kur paraqesin komente për projekt propozimet (në vend që të përdorin kanale joformale) ..... 28

**Rekomandimi 20:** ZQM duhet të organizojë takime në nivelin lokal me ministrinë e linjës dhe OSHC-të për të inkurajuar përdorimin e platformës së konsultimeve në internet kur paraqesin komente për projekt propozimet (në vend që të përdorin kanale joformale). 28

**Rekomandimi 21:** ZQM duhet të merr parasysh ndryshimin e rregullores që mbulon konsultimin publik dhe që të bëjë të detyrueshme që paraqitja jozyrtare e komenteve të pasqyrohet në mënyrë transparente në raportet për konsultime ..... 28

#### **Promovimi i platformës së konsultimeve në internet ..... 28**

**Rekomandimi 22:** ZQM duhet të zhvillojë një plan shumëvjeçar të informimit dhe komunikimit për shpërndarjen e informacionit në lidhje me platformën e konsultimit në internet..... 29

**Rekomandimi 23:** ZQM duhet të merr parasysh një fushatë të përgjithshme televizive dhe radiofonike për të inkurajuar qytetarët dhe bizneset që të marrin pjesë në konsultimet publike në platformën për konsultime në internet. .... 29

#### **Promovimi i konsultimeve individuale ..... 29**

**Rekomandimi 24:** Ministrinë e linjës dhe komunat duhet të jenë të detyruara që të shpallin fillimin e konsultimeve publike në internet, p.sh., përmes rrjeteve të tyre sociale në mënyrë që t'u sigurojnë palëve të interesit mundësinë që të përgatiten për pjesëmarrjen e tyre në konsultim ..... 30

**Rekomandimi 25:** ZQM duhet të marrë parasysh një vegëz automatike mes llogarisë së mediave sociale të ZQM dhe platformës së konsultimeve në internet në mënyrë që çdo konsultim i publikuar renditet automatikisht në burimin e saj. Përndryshe, llogaritë e mediave sociale për platformën e konsultimit në internet mund të krijohen që bëjnë të njëjtën gjë. .... 30

**Rekomandimi 26:** Praktika e promovimit të konsultimeve publike përmes kanaleve të mediave (sociale) të institucioneve qeveritare dhe vendimmarrësve përgjegjës duhet të integrohet në procesin e konsultimit publik dhe mundësisht edhe në standardet minimale për konsultim publik. .... 30

**Rekomandimi 27:** ZQM dhe MAPL duhet të vlerësojnë së bashku me komunat mundësitë për të angazhuar mediat lokale për promovimin e konsultimeve publike dhe ngjarjeve të konsultimit..... 30

**Rekomandimi 28:** ZQM, në bashkëpunim me ministritë përkatëse të linjës dhe komunat, duhet të identifikojnë skedarë/raste të profilit të lartë për të cilat mund të organizohet procesi i konsultimit, p.sh., përfshirë konkurset për ese për nxënësit/studentët dhe ngjarjet e konsultimit në secilën komunë. .... 30

### **Përcjellje më e mirë e konsultimeve të mbyllura ..... 31**

**Rekomandimi 29:** ZQM duhet të vlerësojë se si informatat kthyesë pas përmbylljes së konsultimeve mund të përmirësohen sipas kornizës aktuale ligjore. Pas konsultimeve publike mund të mbahen seminare në internet dhe ngjarje të tjera që organizohen lehtë, në mënyrë që të diskutohen parashtrësit dhe përgjigjet e administratës..... 31

**Rekomandimi 30:** Kur të bëhet rishikimi i platformës së konsultimeve në internet dhe i rregullores që mbulon konsultimin publik, ZQM duhet të marrë parasysh kriteret shtesë për informatat kthyesë për të shtuar transparencën në lidhje me atë se si komentet u morën parasysh..... 31

## **Korniza ligjore dhe zbatuese për konsultime publike ..... 32**

### **Vlerësimi zyrtar i rregullores ..... 32**

**Rekomandimi 31:** ZQM duhet të merr parasysh nisjen e një vlerësimi zyrtar ex-post të rregullores për standardet minimale për konsultim publik në vitin 2021..... 32

### **Përfshirja në fazën e hershme dhe konsultimi në vendimmarrje ..... 32**

**Rekomandimi 32:** ZQM duhet të promovojë konsultimin me palët të interesit në fazën e hershme përveç mbledhjes publike që është tashmë e detyrueshme. Në lidhje me rishikimin e mundshëm të rregullores për standardet minimale për konsultim publik, përfshirja e tillë në fazën e hershme të palëve të interesit mund të mishërohet më shumë në kornizën ligjore..... 33

### **Zbatimi më i rreptë i standardeve minimale ..... 33**

Niveli qendror: kërkesa më të rrepta për miratim ..... 33

**Rekomandimi 33:** ZQM duhet të sigurojë se në rishikimin e ardhshëm të Rregullores së Punës të Qeverisë, kërkesat minimale për konsultim publik duhet të respektohen plotësisht përpara se një propozim të miratohet nga Qeveria ose Ministria (për akte të caktuara nënligjore). .... 33

**Rekomandimi 34:** Kur të zhvillohet versioni tjetër i platformës së konsultimeve në internet, ZQM duhet të sigurojë që platforma nuk u mundëson organizatave që të shmangen nga standardet minimale nëse kjo nuk lejohet në mënyrë të qartë..... 34

Niveli lokal: kartela e vlerësimit të rezultatit ..... 34

**Rekomandimi 35:** ZQM dhe MAPL duhet të zhvillojnë një kartelë të vlerësimit të rezultatit në nivel lokal për konsultim publik për të treguar se deri në çfarë shkalle komunat kanë zbatuar kërkesat praktike që kanë të bëjnë me konsultimin publik. Kartelat e vlerësimit të rezultatit duhet të publikohen dhe mund të jenë të lidhura me sistemin e granteve që MAPL ka krijuar për komunat. .... 34

### **Kanale dhe metodologji të shumëfishta të konsultimit ..... 34**

**Rekomandimi 36:** ZQM duhet të vlerësojë se cilat metoda alternative të konsultimit mund të përdoren për të plotësuar platformën e konsultimit publik. Zbatimi i mundshëm i këtyre metodave duhet të integrohet në standardet minimale për konsultim publik ..... 35

**Rekomandimi 37:** ZQM duhet - në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse të linjës ose komunën - të zgjedhë një numër skedarësh me të cilat do të testohen metodat dhe qasjet e reja të konsultimit për të parë vlerën e tyre të shtuar potenciale ..... 35

**Rekomandimi 38:** ZQM duhet, në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe komunat, të vlerësojë nëse është e mundur që logjikisht të paraqiten disa elemente të një propozimi

që tashmë është në konsultim publik, mundësisht përmes platformës së konsultimeve në internet. Për shembull, platforma mund të integrojë mundësinë për të kryer anketa dhe sondazhe ndër organizatat e regjistruara..... 35

## Zhvillimi i kapaciteteve..... 36

### Kapacitetet e ZQM dhe MAPL..... 36

**Rekomandimi 39:** ZQM dhe MAPL duhet të kryejnë një vlerësim afatmesëm të nevojave përkitazi me personelin, trajnimin, asistencën teknike dhe mbështetjen nga donatorët. .... 37

**Rekomandimi 40:** ZQM duhet të merr parasysh përditësimin e kornizës së politikave strategjike që kanë të bëjnë me konsultimet publike për të nxitur përmirësimin e konsultimeve publike edhe më tej në perspektivën politike për Kosovën. Në këtë kontekst, OZHQ-ve mund t'u kushtohet vëmendje më e madhe. .... 37

### Niveli qendror dhe lokal: administrata ..... 37

**Rekomandimi 41:** ZQM duhet të vendosë objektiva të qarta trajnimi për zyrtarët publikë në nivelin qendror dhe atë lokal të cilët trajnohen për konsultimin publik dhe duhet të sigurojë informim të shpejtë brenda administratës përmes trajnimit ..... 37

**Rekomandimi 42:** ZQM, në bashkëpunim me IKAP, duhet të shqyrtojë nëse mund të zhvillohen modulet e trajnimit në internet për konsultim publik..... 37

**Rekomandimi 43:** Së bashku me MAPL dhe IKAP, ZQM duhet të vlerësojë nëse modulet e trajnimit në internet duhet të zhvillohen enkas për nivelin lokal. .... 38

**Rekomandimi 44:** ZQM dhe IKAP duhet të vlerësojnë mundësinë për të zhvilluar dhe për të mbajtur trajnime në lidhje me hartimin e politikave në mënyrë që të përmirësojnë cilësinë e dokumenteve të konsultimit. Kjo mund të plotësohet gjithashtu me një trajnim për trajnerë për këtë temë..... 38

### OSHC në nivel qendror dhe lokal..... 38

**Rekomandimi 45:** ZQM dhe MAPL duhet të vlerësojnë nëse mund të zhvillojnë programe ose aktivitete mbështetëse për OSHC në lidhje me promovimin e përvetësimit dhe pjesëmarrjes në konsultimet publike në nivelin lokal duke filluar në vitin 2021..... 38

**Rekomandimi 46:** ZQM, së bashku me organizatën përgjegjëse për koordinimin e donatorëve, duhet të angazhohen me komunitetin e donatorëve për të vlerësuar mundësitë që ata të mbështesin në një mënyrë më efektive zhvillimin e kapaciteteve të OJQ-ve për pjesëmarrjen në konsultimet publike..... 38

**Rekomandimi 47:** ZQM duhet të ndërmerr një analizë të kapaciteteve të OSHC-ve në nivel qendror dhe lokal (mundësisht në çdo komunë). Në bazë të kësaj analize, ZQM dhe MAPL mund të përcaktojnë modalitetet më të mira të mbështetjes për OSHC-të në periudhën afatmesme..... 38



## LISTA E SHKURTESAVE:

<b>OSHC</b>	Organizatë e Shoqërisë Civile
<b>ENER</b>	Regjistri Unik Elektronik Kombëtar i Rregulloreve të Republikës së Maqedonisë së Veriut
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>IKAP</b>	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
<b>MAPL</b>	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
<b>OJQ</b>	Organizatë Joqeveritare
<b>OECD</b>	Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillim Ekonomik
<b>ZQM</b>	Zyra e Qeverisjes së Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit
<b>ZKM</b>	Zyra e Kryeministrit
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>OZHQ</b>	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
<b>SIGMA</b>	Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit' (nismë e përbashkët e OECD-së dhe Bashkimit Evropian)
<b>TT</b>	Trajnim për trajnerë
<b>UNCRPD</b>	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

## INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Transparenca është faktor kyç që ndikon në rritjen e llogaridhënies në administratën publike dhe si rrjedhojë rrit edhe performancën e saj. Transparenca siguron që qeveritë të jenë më të drejta dhe të i marrin parasysh interesat e përgjithshme të shoqërisë në mënyrë pro aktive.

Konsultimi Publik kontribuon ndjeshëm në transparencën e qeverisë dhe proceset e saj të vendimmarrjes. Zbatimi efektiv i konsultimit publik në praktikë siguron që politikat dhe legjislacioni të hartohen në mënyrë gjithëpërfshirëse, falë mundësisë që u ofrohet aktoreve të jashtëm për të marrë pjesë dhe kontribuar në mënyrë aktive. Konsultimi publik zgjeron fushën e çështjeve që merren parasysh gjatë hartimit të politikave të qeverisë, duke përmirësuar kështu cilësinë e atyre politikave në masë të konsiderueshme. Për më tepër, pritjet janë që politikat dhe legjislacioni që kanë kaluar në konsultime me publikun do të zbatohen në mënyrë më efikase.

### **Konsultimet publike, Integrimi Evropian dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm**

Vendimmarrja efektive dhe gjithëpërfshirëse është element jetik i procesit të Integritimit Evropian. Zhvillimi dhe realizimi të reformave, transpozimi dhe implementimi i legjislacionit evropian (Acquis) si dhe siguria për qytetarët dhe bizneset që edhe kur të ndodhin ndryshimet ata do të jenë thelbësore ë procesit që çon përfundimisht në anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Kjo nënvizohet nga fakti se Raportet e Komisionit Evropian për Kosovën<sup>1</sup> rregullisht theksojnë arritjet dhe sfidat që ende ekzistojnë në lidhje me konsultimet publike.

Për më tepër, OECD/SIGMA rregullisht vlerëson proceset e integritimit evropian bazuar në 'Parimet e Administratës Publike'<sup>2</sup>. Parimi 11 në fushën 'Zhvillimi dhe Koordinimi i Politikave' vlerëson cilësinë e kornizës rregullatore për konsultimet publike si dhe zbatimin e kësaj kornize në praktikë.

OZHQ16<sup>3</sup> i referohet promovimit të shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, duke siguruar qasje në drejtësi për të gjithë dhe ndërtim të institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha

---

<sup>1</sup> Shih: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>; [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf)

<sup>2</sup> Shih: <http://www.sigmaxweb.org/publications/Principles-of-Public-Administration-2017-edition-ENG.pdf>

<sup>3</sup> Shih: <https://sdgs.un.org/goals/goal16>

nivelet. Ky objektiv bën thirrje, ndër të tjera, për një përdorim sistematik të konsultimit publik në proceset e politikë bërjes dhe ligj bërjes të organeve qeveritare.

### Progresi me konsultimet publike deri në vitin 2020

Në vitin 2016, Qeveria e Kosovës miratoi Rregulloren nr. 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik". Kjo rregullore hyri në fuqi më 1 janar 2017. Ajo përcakton çështjet si koha minimale që duhet tu sigurohet aktorëve të ndryshëm për t'i ofruar përgjigjet e tyre në konsultat në internet, përcakton rregullat për organizimin e takimeve, përcakton kërkesat për raportim dhe rregullon mënyrën në të cilën duhet të raportohet për rezultatet e konsultimeve publike.

Figura 1: Roli i Zyrës për Qeverisje të Mirë

Për sa i përket zbatimit të Rregullores nr. 05/2016 dhe përmirësimit të praktikës së konsultimeve publike në Kosovë, Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit është përgjegjëse për:

- Krijimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e platformës së konsultimeve publike në internet
- Raportimin mbi zbatimin e rregullores për standardet minimale për konsultim publik, përfshirë raportin vjetor të konsultimeve publike;
- Koordinimi i rrjetit të koordinatorëve të konsultimit publik në nivel qeveritar;
- Bashkëpunimin me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në lidhje me zbatimin e konsultimeve publike në nivelin lokal dhe koordinimin e rrjetit të atëhershëm të Koordinatorëve të Konsultimit Publik në nivelin lokal
- Koordinimin me Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP) për trajnimet dhe zhvillimin e kapaciteteve
- Ndërlidhjen me shoqërinë civile dhe OJQ-të në lidhje me zbatimin e standardeve minimale, veçanërisht përmes Këshillit për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile
- Koordinimin dhe zhvillimin e aktiviteteve dhe politikave që synojnë përmirësimin e zbatimit të standardeve për konsultimet publike
- Kontributin në zhvillimin e kapaciteteve për shoqërinë civile në mënyrë që të marrë pjesë aktivisht në procesin e konsultimit publik

Në muajin shkurt 2017, Qeveria lansoi platformën për konsultime publike në internet <http://konsultimet.rks-gov.net/> që përdoret nga ministritë e linjës për publikimin e drafteve të dokumenteve që i nënshtrohen konsultimeve. Platforma

u mundëson aktorëve përkatës dhe publikut që të paraqesin komente dhe të japin përgjigje në temat që shqyrtohen për miratim.

Në vlerësimin e procesit të konsultimit publik më 2017, OECD/SIGMA atribuoi rezultatin maksimal (10 nga 10 pikë) për nën-treguesin e lidhur me përshtatshmërinë e kuadrit rregullativ për një proces efektiv të konsultimit publik. Kjo thekson se korniza ligjore përfshin të gjitha aspektet përkatëse dhe praktikat më të mira ndërkombëtare për rregullimin e konsultimeve publike.

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2019<sup>4</sup> vlerëson që konsultimet publike nga qeveria janë përmirësuar, përfshirë përmes një përdorimi të shtuar të konsultimeve publike në internet. Raporti konfirmon që konsultimet publike organizohen më rregullisht. Është vlerësuar se kjo është për shkak të respektimit dhe zbatimit të standardeve minimale për konsultime publike. Për më tepër, në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën 2020<sup>5</sup> theksohet se konsultimet publike organizohen rregullisht, por standardet minimale për konsultime të tilla nuk ndiqen në mënyrë të vazhdueshme.

Raporti i parë vjetor mbi konsultimet publike të qeverisë u hartua në maj 2018 dhe është publikuar çdo vit që prej asaj kohe.

Në vitin 2020, u zgjerua platforma e konsultimit online. Përveç që përdoret nga ministritë e linjës për të konsultuar publikun mbi draft dokumentet, edhe komunat tani janë gjithashtu të përfshira në platformë. Tani ato kanë mundësinë që të konsultohen me publikun në të njëjtën mënyrë siç kanë mundur ta bëjnë institucionet e nivelit qeveritar për disa vite tani.

Në vitin 2020, Zyra për Qeverisje të Mirë bashkë me Institutin e Kosovës për Administratë Publike përfundoi programin Trajnim për Trajnues për konsultime publike. Janë certifikuar dhjetë trajner dhe trajnerët e certifikuar pritët të ofrojnë trajnime për konsultimet publike më 2021, duke kontribuar kështu në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve.

## **Performanca e konsultimeve 2017-2020**

Përvoja me platformën e konsultimeve në internet ka qenë shumë pozitive, në lidhje me publikimin e dokumenteve në internet. Gjithsej janë identifikuar dhe monitoruar tetë kategori të dokumenteve. Këto janë paraqitur në tabelën më poshtë me numrin vjetor të dokumenteve përkatëse të miratuara nga Qeveria të

---

<sup>4</sup> Shih: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>.

<sup>5</sup> Shih: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf).

paraqitur së bashku me përqindjen e dokumenteve që janë publikuar në platformën e konsultimit në internet.

Statistikat tregojnë një shkallë të lartë të dorëzimit të dokumenteve për konsultime publike përmes platformës në internet. Për më tepër, shifrat tregojnë se në vitin 2020, përkundër efekteve të masave të marra për të kufizuar përhapjen e Covid-19, faqja e internetit e konsultimit ishte përdorur akoma në mënyrë efektive për t'u angazhuar me publikun e gjerë në një kohë kur nuk ishte e mundur të takoheshim në cilësimet ballë për ballë.

Figura 2: Të dhënat vjetore mbi përdorimin e platformës së konsultimeve në internet publik

	2017 <sup>6</sup>	2018 <sup>7</sup>	2019 <sup>8</sup>	2020 <sup>9</sup>
Numri i përgjithshëm i dokumenteve të miratuara	245	237	274	184
% -e publikimeve në internet	90%	96%	100%	98%
Koncept-dokumentet	25	27	15	15
Ligjet	40	43	31	44
Planet e veprimit	4	8	7	5
Rregulloret	46	66	77	42
Udhëzimet administrative	92	63	129	69
Strategjitë	9	18	6	3
Progamet	0	0	5	3
Të tjerët	5	3	8	0

### Sfidat me konsultimet publike

Përkundër përparimit të realizuar në fushën e konsultimit publik, ka ende sfida të mëdha që duhet adresuar në mënyrë që të vilen përfitimet e plota që ofrohen nga konsultimi publik. Zbatimi i plotë i standardeve minimale ende nuk është i garantuar dhe kërkon angazhim dhe burime të konsiderueshme shtesë.

<sup>6</sup> Shih <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-5c7905ab86aa1.pdf>

<sup>7</sup> Shih <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-5d1f2441afb2a.pdf>

<sup>8</sup> Shih <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-5ea09893862a6.pdf>

<sup>9</sup> Shih <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-606c64aa41753.pdf>

Për më tepër, përderisa njihet progresi i bërë në lidhje me konsultimin publik, Raportet e Komisionit Evropian për Kosovën për 2019<sup>10</sup> dhe 2020<sup>11</sup> gjithashtu theksojnë se shkalla e përgjigjes nga shoqëria civile dhe qytetarët në konsultat publike përmes platformës së konsultimeve në internet mbetet relativisht e ulët. Qeveria duhet të shtojë përpjekjet për të promovuar përdorimin e platformës për të tejkaluar mungesën e vërejtur të debatit thelbësor mbi projekt legjislativ.

Analiza e BE-së gjithashtu thekson se disa organe publike ende kanë kapacitete të kufizuara për t'i zbatuar detyrimet e tyre ligjor të konsultimit. Për më tepër, institucionet duhet të shtojnë përpjekjeve të tyre për të siguruar informata kthyesë më konsistente dhe më kuptimplote për inputin e marrë. Së fundi, por jo më pak me rëndësi, llojet e mjeteve të konsultimit të përdorura duhet të sigurojnë konsultime të gjera me palët e interesit, që do të thotë që duhet të zbatohen metoda të ndryshme të konsultimit në mënyrë që të arrihet një audiencë më e gjerë dhe grupe specifike të synuara.

Me përfshirjen e nivelit lokal në platformën online për konsultime publike, raporti i BE 2019 paralajmëron se cilësia e konsultimit publik në nivelin lokal ende është shqetësuese.<sup>12</sup> Megjithatë, kjo nuk është për t'u habitur meqë kjo praktikë është shumë e re.

Në raport janë identifikuar edhe fusha shtesë për përmirësim, bashkë me rekomandime, për të përmirësuar konsultimet publike në Kosovë. Për shembull, kudo në nivel qendror dhe atë lokal, kapacitetet për konsultime publike të nëpunësve civilë duhet të përmirësohen; shoqëria civile duhet të forcohet për të qenë në gjendje të merr pjesë në mënyrë efektive në procesin e konsultimit publik në nivelin qendror dhe lokal në mënyrë sistematike; për ta bërë pjesëmarrjen në konsultimet në internet më tërheqëse dhe më të lehtë. Platforma online për konsultimet në internet duhet të përmirësohet dhe përditësohet. Përderisa përgjithësisht mbulon të gjitha veçoritë e njohura ndërkombëtarisht, duhet të detajohet më tutje për tu përshtatur plotësisht me kontekstin kombëtar dhe lokal për kryerjen e konsultimeve individuale dhe raportimin mbi konsultimet publike.

---

<sup>10</sup> "Konsultimet publike organizohen më rregullisht, falë standardeve minimale për konsultime të tilla. Në vitin 2018, më shumë se 50% e të gjitha dokumenteve kryesore të politikave dhe projektligjeve u publikuan për konsultime në faqen e internetit; kjo paraqet një rritje të konsiderueshme që nga viti 2017. Meqë shkalla e reagimit nga shoqëria civile dhe publiku mbetet relativisht e ulët, qeveria po bën përpjekje për të promovuar përdorimin e faqes në internet" <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>.

<sup>11</sup> "Konsultimet publike organizohen rregullisht, por standardet minimale për konsultime të tilla nuk po ndiqen në mënyrë të vazhdueshme. Në vitin 2019, më shumë se 82% e të gjitha dokumenteve kryesore të politikave dhe projektligjeve u publikuan për konsultime në faqen e internetit. Meqë shkalla e reagimit nga shoqëria civile dhe publiku mbetet relativisht e ulët, qeveria po bën përpjekje për të promovuar përdorimin e faqes në internet" [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf)

<sup>12</sup> "Kanë vazhduar përpjekjet për të përmirësuar kapacitetin dhe ofrimin e shërbimeve në qeveritë lokale. Por, cilësia e konsultimit publik në nivel lokal mbetet shqetësuese." <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>

## Rekomandime për përmirësimin e konsultimit publik

Për të krijuar një bazë të fortë për përmirësimin e konsultimit publik për vitet e ardhshme, Zyra për Qeverisje të Mirë ka realizuar një seri punëtorish për të mbledhur informata kthyesë të drejtpërdrejta nga palët përkatëse të interesit. Gjithashtu, janë zhvilluar analiza shtesë dhe mbledhje të informatave nga ekspertë për të identifikuar fushat për përmirësimin e konsultimit publik.

Fushat kryesore ku nevojiten përmirësime në konsultimet publike janë si më poshtë:

- Qëndrueshmëria e mbështetjes politike: zgjerimi i thirrjes së konsultimit publik në nivelin qendror dhe lokal
- Përmirësimi i funksionalizimit të platformës së konsultimeve online;
- Vizibiliteti i platformës së konsultimeve online
- Korniza ligjore dhe zbatuese për konsultim publike;
- Investimi në zhvillimin e kapaciteteve;

Këto pesë fusha janë shtjelluar më në detaje në këtë raport, duke filluar me prezantimin e organizimit të punëtorive përmes së cilave u bashkuan një numër i konsiderueshëm i ideve dhe sugjerimeve për zhvillimin e rekomandimeve. Secila prej pesë fushave kryesore është e ndarë në përbërës logjike në kuadër të së cilës janë formuluar rekomandimet konkrete.

## **IDENTIFIKIMI I REKOMANDIMEVE PËRMES PUNËTORIVE TË SYNUARA TË KONSULTIMIT**

Përmes një serie prej tri punëtorive, ZQM angazhoi koordinatorët për konsultime publike në ministritë e linjës në nivelin qendror dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile aktive në nivelin qendror dhe lokal.

Gjetjet nga punëtoritë janë paraqitur në tekstin më poshtë.

Gjetjet tregojnë se në vitet e kaluara janë bërë hapa të rëndësishëm progresi. Kosova ka zhvilluar rregulloren për standardet minimale për konsultime publike; ka krijuar platformën e konsultimit në internet; ka implementuar një rrjet funksional të koordinatorëve të konsultimit publik në nivelin qendror; ka përfunduar TT për konsultime publike; ka filluar programin e trajnimit për konsultimin publik; dhe ka filluar zbatimin e konsultimit publik në nivelin lokal, si dhe përmes rregullores së MAPL-së për konsultimin publik dhe integrimin e komunave në platformën e konsultimit publik.

Platforma për konsultime në internet përdoret rregullisht nga administrata. Pandemia COVID-19 dhe ndryshimi i dy qeverive në vitin 2020 treguan se rrjeti i konsultimit publik në nivelin qeveritar, menaxhimi nga ZQM është përgjithësisht i vendosur mirë në administratën e Kosovës.

Në të njëjtën kohë, të gjithë pjesëmarrësit në seminare pranuan se ishte e nevojshme të bëhet më shumë për të përmirësuar situatën aktuale. Ndërsa platforma online e konsultimeve në internet është element thelbësor në kornizën e konsultimit, ajo ende nuk mund të konsiderohet të jetë urë efektive dhe funksionale midis administratës nga njëra anë, dhe publikut, shoqërisë civile dhe grupeve të tjera të interesit nga ana tjetër.

Praktika e konsultimit publik anon fuqishëm në përdorimin e platformës së konsultimit dhe e zbehë përdorimin e teknikave dhe metodologjive të tjera të konsultimit, veçanërisht gjatë fazave të hershme të vendimmarrjes. Mund të konsiderohen funksione të reja dhe të përmirësuara të IT për platformën. Zhvillimi i kapaciteteve në nivelin qendror dhe lokal duhet të vazhdojë. Vizibiliteti i platformës mund të përmirësohet më tej dhe rregullorja për standardet minimale për konsultim publik mund të rishikohet për të filluar fazën tjetër të zhvillimit të konsultimit publik në Kosovë.

Mundësitë, mangësitë dhe sfidat e identifikuara së bashku nënkuptojnë që vlera aktuale e shtuar e procesit të konsultimit ende nuk është plotësisht e garantuar. Propozimet e paraqitura në këtë raport rrjedhin nga punëtoritë dhe njohuritë e



ekspertit të përfshirë në këtë proces të mbledhjes së informacionit, identifikimit të çështjeve dhe zhvillimit të rekomandimeve. Propozimet pritet të kontribuojnë në zhvillimin e një qasjeje të përmirësuar të konsultimit publik. Ato i sigurojnë ZQM-së kornizën e përgjithshme për të përmirësuar bazën ligjore, praktikën, promovimin dhe zbatimin teknik të konsultimit publik në Kosovë.

## **QËNDRUESHMËRIA E MBËSHTETJES POLITIKE: ZGJERIMI I THIRRJES SË KONSULTIMIT PUBLIK NË NIVELIN QENDROR DHE LOKAL**

Qëndrueshmëria e mbështetjes politike në nivel qendror dhe lokal për të realizuar konsultime efektive dhe të dobishme është thelbësore për adresimin e shumë prej sfidave që lidhen me situatën aktuale.

Përfundimisht, vendimmarrësit politikë janë hallka e fundit e pjesëmarrjes në procesin e konsultimit publik. Kjo përfshin kryeministrin, zëvendës kryeministrat, ministrat e qeverisë, zëvendës ministrat, kryetarët e komunave, kryetarin e kuvendit, deputetët, kryesuesit e kuvendeve komunale, anëtarët e asambleve komunale, stafin e tyre politik mbështetës dhe partitë politike në përgjithësi.

Së bashku, këta njerëz formojnë një grup të gjerë që duhet të vendosë për mënyrën në të cilën mund të përmirësohet konsultimi publik (përfshirë aspektet praktike siç janë alokimi i buxhetit dhe stafit për zbatimin e kërkesave të konsultimit). Për më tepër, po ky grup është përfituesi përfundimtar i procesit të konsultimit meqë angazhimi i palëve të interesit në procesin e vendimmarrjes kontribuon në cilësinë e vendimeve politike në të gjitha nivelet.

Është me rëndësi jetike të kihet parasysh se ky grup ndryshon rregullisht për shkak të zgjedhjeve dhe ndryshimit natyror të përbërjes së asambleve gjatë mandatit të tyre. Kjo do të thotë që qasja e njëhershme për konsultimet publike mund të pritet të ketë ndikim të zbehur me kalimin e kohës.

Konsultimi publik duhet të përkrahet plotësisht nga vendimmarrësit politikë. Ata duhet të jenë në dijeni për përfitimet e procesit dhe gjithashtu të përfshihen në momentet kryesore të konsultimit. Përmes rrjeteve të tyre, lidhjeve mediatike dhe pranisë në media sociale ata janë në gjendje të luajnë një rol jetik në promovimin e kornizës së konsultimeve dhe më me rëndësi, konsultimeve individuale që po fillojnë. Një angazhim i tillë për konsultimin publik mund të pritet të ketë ndikim pozitiv në shkallën e pjesëmarrjes së shoqërisë civile më të gjerë publike.

**Rekomandimi 1:** Në vitin 2021, ZQM duhet të organizojë një konferencë të nivelit qendror me përfshirje politike të nivelit të lartë që mbulon gjerësisht konsultimin publik. Kjo konferencë mund të përfshijë edhe tema të tjera që kanë të bëjnë me qeverisjen e mirë. Fokusi i një konference të tillë duhet të jetë në vlerën e shtuar të procesit të konsultimit për vendimmarrjen politike.

**Rekomandimi 2:** Pas konferencës më 2021, ZQM duhet të vlerësojë se si të sigurojë një angazhim të vazhdueshëm të nivelit politik. Kjo mund të jetë duke vazhduar konferencën për konsultime publike/ qeverisje të mirë në një plan dyvjeçar duke organizuar ngjarje të dedikuara në vitin e ndërmjetëm.

## **PËRMIRËSIMI I FUNKSIONALIZIMIT TË PLATFORMËS ONLINE TË KONSULTIMEVE**

Platforma e konsultimeve online në internet është operacionale dhe përdoret në mënyrë aktive. Sidoqoftë, punëtoritë theksuan që funksionalitetet e faqes së internetit mund të përmirësohen më tej dhe të përdoren modalitete të reja teknologjike, që veçse janë në dispozicion, për ta bërë më të lehtë për palët e interesit që të marrin pjesë në konsultime individuale dhe që administrata të raportojë mbi to.

### **Takime publike në internet: veçori e re e platformës**

Pandemia COVID-19 ka nënvizuar rëndësinë e të qenit në gjendje të mbajmë takime në internet me palët e interesit. Në vitet e mëparshme, organizimi i takimeve publike ishte bërë me prani fizike. Kjo nënkuptonte se pjesëmarrësit në takime duhej të udhëtonin deri te vendi ku mbahej takimi. Ndërsa është e qartë që, në varësi të situatës, ministritë mund të organizojnë takime, me prani fizike ose në internet, ky aspekt i konsultimeve publike mund të rregullohet më tej. Pavarësisht nga fakti që ndikimi i pandemisë COVID-19 ishte ndjeshëm negativ në shumë mënyra, disa mësimet, të vlefshme për këtë raport, mund të nxirren prej saj.

Për sa i përket organizimit të takimeve zyrtare publike të kërkuara me standardet minimale, këto takime, por dhe të tjera (p.sh. për grupet e punës), mund të organizohen më shpesh në mjedise në internet, ose i kombinuar. Një praktikë e tillë do të mundësonte që më shumë njerëz të ndjekin dhe marrin pjesë në këto takime. Kërkesat teknike janë relativisht të lehta për t'u zbatuar me shërbimet aktualisht në dispozicion të takimeve në internet.

Takimet që organizohen, në veçanti takimet zyrtare publike, duhet të lajmërohen në platformën e konsultimeve, së bashku me mundësinë për regjistrim në këto takime. Sipas nevojës, pjesëmarrja në hapësirat fizike mund të kufizohet për shkak të madhësisë së sallës por një takim plotësisht në internet ose hibrid nuk do të kishte kufizime në numrin e pjesëmarrësve në takim (varësisht nga platforma e takimeve që përdoret). Një përfitim shtesë është se takimet në internet dhe ato të kombinuara mund të regjistrohen dhe të shërbejnë si dëshmi e konsultimit të kryer dhe si input për palët e interesit.

**Rekomandimi 3:** *ZQM duhet të konsiderojë integrimin e përdorimit të takimeve në internet ose atyre të kombinuara si tipar standard në procesin e konsultimit për të nxitur pjesëmarrjen duke ulur pragjet e pjesëmarrjes. Takimi zyrtar publik në fillim të procesit të vendimmarrjes mund të organizohet gjithmonë si takim i kombinuar.*

**Rekomandimi 4:** *ZQM duhet të konsiderojë rregullimin e platformës në internet të konsultimit për t'i mundësuar njerëzve që të regjistrohen për takime dhe të marrin automatikisht informacion për t'u bashkuar në takimin në internet. Kjo do ta bënte më të lehtë pjesëmarrjen dhe gjithashtu më të lehtë për ministritë që ta menaxhojnë organizimin e takimit.*

### **Qasja për personat me aftësi të kufizuara dhe respektimi i Direktivës së BE-së për Qasje në Ueb**

Platforma online e konsultimit aktualisht është e bazuar në dokument dhe në tekst. Kjo e bën më të vështirë për grupe të caktuara që të kenë qasje në informatat e paraqitura në platformë. Gjithashtu, kjo do të thotë që faqja në internet nuk është në përputhje me Direktivën e BE-së për Qasje në Ueb.

## Direktiva e BE-së për Qasje në Ueb

Qasja në ueb nuk ka të bëjë vetëm me standardet teknike, arkitekturën dhe dizajnin e uebit. Është çështje e vullnetit politik dhe e detyrimit moral, e parashikuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (UNCPRD). Neni 9 i Konventës, palë e së cilës janë BE-ja dhe Shtetet Anëtare, kërkon që të merren masat e duhura për të siguruar qasje të personave me aftësi të kufizuara, mbi baza të barabarta me të tjerët, në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, përfshirë internetin.

Direktiva për qasje në Ueb;

- mbulon faqet e internetit dhe aplikacionet e organeve të sektorit publik, me një numër të kufizuar të përjashtimeve (p.sh. transmetuesit, transmetimi i drejtpërdrejtë);
- i referohet standardeve specifike për t'i bërë faqet e internetit dhe aplikacionet mobile më të qasshme. Standardet e tilla kërkojnë, për shembull, që duhet të ketë një përshkrim teksti për imazhe, ose që përdoruesit të jenë në gjendje të bashkëveprojnë me një faqe në internet pa përdorur miun, gjë që mund të jetë e vështirë për disa persona me aftësi të kufizuara;
- kërkon publikimin e një deklaratë të qasjes për secilën faqe në internet dhe aplikacionin celular, duke përshkruar nivelin e qasjes dhe duke treguar çdo përmbajtje që nuk është e qasshme;
- bën thirrje për një mekanizëm fidbeku që përdoruesit mund të përdorin për t'i theksuar problemet me qasje ose për të kërkuar informata që janë në format të pa qasshëm.

Burimi: <https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/web-accessibility>

Karakteristikat që përmirësojnë qasjen për personat me aftësi të kufizuara duhet të integrohen në faqen e internetit sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që t'i adresojnë nevojat e tyre.

Pas përditësimit substancial, platforma e konsultimit në internet duhet të jetë tërësisht në pajtim me standardet e përcaktuara në Direktivën për qasje në Ueb dhe të integrojë zgjidhje të ndryshme të TI-së që mundësojnë personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë plotësisht në procesin e konsultimit.

**Rekomandimi 5:** ZQM duhet të integrojë tipare në platformën e konsultimeve në internet në vitin 2021 të cilat rrisin mundësinë e qasjes për personat me aftësi të kufizuara.

**Rekomandimi 6:** Gjatë rishikimit të arkitekturës bazike të platformës së konsultimit në internet, ZQM duhet të sigurojë zbatim të plotë të Direktivës së BE për Qasje në Ueb dhe t'i integrojë tiparet më të fundit që mundësojnë qasje të plotë për personat me aftësi të kufizuara.

### **Dorëzimi i komenteve për përdoruesit**

Dorëzimi i komenteve në konsultimet publike të organizuara përmes platformës në internet është vlerësuar të jetë i vështirë. Mënyra në të cilën duhet të dërgohen komentet nuk është e përshtatshme për përdoruesit. Parashtrimi i lehtë dhe i thjeshtë i komenteve. Parashtrimi i komenteve në konsultimet publike që janë të organizuara përmes platformës në internet konsiderohet si i ndërlikuar.

Mënyra sipas së cilës duhet të parashtrihen komentet nuk është e përshtatshme për përdoruesit. Pjesëmarrësit në konsultimin publik duhet të shkarkojnë dokumentet përkatëse, të vendosin komentet në këto dokumente dhe t'i ngarkojnë ato përsëri. Ndonëse nga profesionistët mund të pritët që të marrin pjesë në mënyrë efektive si pjesë e punës së tyre, organizimi aktual vendos një barrë të madhe mbi individët të cilët do të donin të parashtronin komentet e tyre. Kjo barrë nuk ka të bëjë vetëm me kohën, por edhe kushtin e nënkuptuar për të pasur kompjuter laptop dhe licenca softuerësh për programe specifike.

Tashmë ekzistojnë platforma dhe programe të ndryshme në dispozicion që e bëjnë pjesëmarrjen elektronike shumë më të lehtë, të tilla si Citizens OS (shih kutinë më poshtë). Një platformë konsultimi që është plotësisht e automatizuar dhe në të cilën komentet dhe të dhënat e pjesëmarrjes mbledhen në mënyrë automatike do të ishin më të lehta për t'u përdorur. Një sistem i tillë do të ishte gjithashtu më transparent dhe më i prekshëm sesa që është platforma e konsultimeve në internet tani për tani.

## Citizens OS

Vizioni i 'Citizens OS' është të fuqizojë sa më shumë që është e mundshme qytetarë për të marrë pjesë në diskutime të respektueshme dhe kuptimplota. Qëllimi është që të lehtësojë vendimet kolektive për çështjet që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e njerëzve.

Ajo është një teknologji civile me burim të hapur, jo-fitimprurëse, me seli në Talin, Estoni dhe u fut në përdorim real në shtator të vitit 2015.

Karakteristikat e 'Citizens OS' janë:

- 100% falas për t'u përdorur, përgjithmonë. Pa reklama, pa tarifa.
- Është një platformë e gatshme.
- Tashmë është në 13 gjuhë dhe është e lehtë për t'u përkthyer.
- Diskutime pro dhe kundër për debate të baraspeshuara.
- Diskutime private ose publike.
- Grupet private për diskutime të shumëfishta me të njëjtët njerëz.
- Votim i përshtatur enkas dhe anonim me afate.
- Karakteristika të avancuara të votimit të tilla si mini-vota dhe delegimi.
- Përputhet me e-ID, për hyrje, votim dhe nënshkrime digjitale.

Burimi: <https://citizenos.com>

Është e qartë se ekzistojnë shembuj të praktikave të mira në bazë të të cilave mund të dizajnohet përmirësimi i platformës së konsultimeve në internet. Këto duhet të mblidhen dhe analizohen në mënyrë që të vlerësohet se çfarë mund të implementohet në Kosovë dhe platformën e saj për konsultime publike.

**Rekomandimi 7:** ZQM duhet të vlerësojë mundësitë më të fundit për thjeshtëzimin e angazhimit të qytetarëve dhe duhet të shqyrtojë se cilat tipare mund të zbatohen përmes platformës së konsultimeve në internet.

**Rekomandimi 8:** ZQM duhet të vlerësojë nisma të tilla si 'Citizens OS' dhe duhet të angazhohet drejtpërdrejt me ekspertët kryesorë nga nisma të tilla përmes punëtorive gjegjëse dhe vizitave.

**Rekomandimi 9:** ZQM duhet të vlerësojë cilësinë e platformave të konsultimit publik në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe duhet të vlerësojë se cilat praktika më të mira mund të zbatohen në Kosovë. Organizimi i shkëmbimeve duhet të parë në këtë kontekst.

### Konsultimet e bazuara në aplikacione

Me përdorimin e gjerë të telefonave celularë, konsultimi përmes uebfaqes duhet të plotësohet me një aplikacion të lehtë përdoruesit në telefona të mençur.

**Rekomandimi 10:** Kur të ridizajnohet Platforma e konsultimeve në internet, ZQM duhet të vlerësojë mundësinë për të zhvilluar një version të aplikacionit të uebfaqes që mundëson pjesëmarrje më të lehtë përmes telefonave të mençur.

### Përgjigja nen për nen

Një tipar praktik që duhet të merret parasysh është ngarkimi i propozimeve legislative në një format tjetër që u mundëson pjesëmarrësve në konsultimin publik të japin përgjigje ndaj neneve të veçanta në vend të tërë dokumentit dhe duke shpjeguar se ndaj cilit element, neni të dokumentit, po japin përgjigje. Kjo qasje, përveç projektligjeve dhe akteve nënligjore, dokumenteve që janë të ndara në nene, mund të zbatohen edhe për strategjitë dhe koncept dokumentet duke bërë ndarje logjike të tekstit.

Pjesëmarrësit në konsultim duhet të jenë në gjendje t'i japin komentet drejtpërdrejtë, pa pasur nevojë që të shkarkojnë dokumente.

Parakushti është që platforma të sigurojë mënyrën për administratën për të dhënë dosje konsultimi në formate që mundësojnë përgjigjen nen për nen.

Kjo qasje do t'u mundësonte pjesëmarrësve në konsultim që të bëjnë komente vetëm për disa elemente që ata i konsiderojnë të rëndësishme. Kjo mund të mbështet shkallën e pjesëmarrjes pasi vetë sistemi do të ofronte mundësinë edhe për komente më të shkurta dhe më të drejtpërdrejta.

**Rekomandimi 11:** *ZQM duhet të vlerësojë mundësinë për t'u mundësuar pjesëmarrësve në konsultim që të japin komente nen për nen. Kjo do ta bënte pjesëmarrjen më të lehtë dhe do ta thjeshtonte raportimin për administratën.*

### **Përgjigja në kohë reale**

Me komente për nene të veçanta dhe pjesë të dokumenteve, administrata do të ishte në gjendje që jepte informata kthyesë gjatë procesit të konsultimit. Zyrtarët gjithashtu do ta kishin mundësinë që të kërkojnë informata shtesë dhe/ose sqarime.

Nga aspekti teknik, një tipar i tillë do të ishte i thjeshtë për t'u zbatuar. Sidoqoftë, kjo lypset një strukturë të ndryshme të procesit të konsultimit dhe që administrata të ndjekë procesin e konsultimit në internet në mënyrë proaktive. Pranimi i një përgjigje të shpejtë (me përditësimin se përgjigja e tillë është dhënë nga administrata), mund të pritët që të rrisë nivelet e pjesëmarrjes pasi që pjesëmarrësit e konsultimit do të shohin që kontributi i tyre merret parasysh në mënyrë transparente dhe serioze.

**Rekomandimi 12:** *ZQM duhet të përcaktojë kushtin që administratat të japin përgjigje/ informata kthyesë menjëherë kurdoherë që është e mundshme, ndërsa procesi i konsultimit publik është duke vazhduar në platformën në internet kur të futet mundësia e përgjigjes nen për nen.*

### **Grupet e punës të publikuara në platformën e konsultimit në internet**

Administrata punon me grupe pune për zhvillimin e ligjeve, akteve nënligjore, strategjive dhe koncept dokumenteve. Në përgjithësi, sekretari i përgjithshëm i një ministrie nënshkruan vendimin për krijimin e këtyre grupeve të punës.

OSHC-të mund të ftohen që të marrin pjesë si anëtarë aktiv në këto grupe pune. Sidoqoftë, sistemi aktual i organizimit dhe funksionimit të grupeve të punës nuk është transparent. Për më tepër, shumë OSHC konsiderojnë se ato nuk ftohen gjithmonë që të marrin pjesë në grupe pune që janë shumë të rëndësishme për ato pasi temat që diskutohen nga këto grupe pune janë drejtpërdrejtë të lidhura me çështjet në të cilat janë të përqendruara këto OSHC.



Platforma e konsultimeve në internet mund të përdoret për të publikuar të gjitha vendimet për krijimin e grupeve të punës. Kjo duhet të bëhet në një format që është i lehtë për t'u kërkuar jo vetëm si skanime ose format PDF.

Organizatave të interesuara më pas do të jenë në gjendje që të vlerësojnë nëse një grup pune mund të jetë i rëndësishëm për ata dhe mund t'ia tregojnë këtë ministritë përgjegjëse. Në anën tjetër, ministria përgjegjëse më pas mund të vlerësojë nëse do të ishte e dobishme të zgjerohet anëtarësia e një grupi pune ose nëse organizata që ka shfaqur interesim mund të përfshihet në ngjarje më të synuara për konsultimin e palëve të interesit.

Me qëllim që të ruhet sistemi efektiv i grupeve të punës, duhet të ketë një afat kohor prej dy javësh brenda të cilave organizatat mund të tregojnë se e konsiderojnë temën e mbuluar nga grupi relevant dhe që ata do të donin të merrnin pjesë si anëtarë aktivë. Vendimet për grupet e punës duhet të mbesin të publikuara pasi palët e interesuara duhet të jenë në gjendje që në çdo moment të tregojnë se do të donin që të angazhoheshin me një grup pune për të siguruar përfaqësim, që të marrin pjesë në një ngjarje të caktuar konsultimi, që t'i paraqesin informata përkatëse këtij grupi ose që të marrin pjesë në ndonjë mënyrë tjetër në procesin e vendimmarrjes.

**Rekomandimi 13:** *ZQM duhet të marrë parasysh obligimin që ministritë e linjës duhet të publikojnë vendimet për grupet e punës të krijuara të cilat janë përgjegjëse për zhvillimin e ligjeve, akteve nënligjore, strategjive, koncept dokumenteve, etj., ashtu që palët e interesuara duhet të jenë në gjendje që të paraqesin brenda dy javësh një propozim të arsyetuar për atë se pse ata e konsiderojnë se është e rëndësishme që të ftohen si anëtarë aktivë të një grupi të tillë pune. Palët e interesit duhet të jenë në gjendje në çdo moment të dhënë që të tregojnë se ata do të donin të angazhoheshin me anëtarët e grupit të punës për t'iu dëgjuar zëri i tyre.*

### **Raportimi për konsultimet publike**

Ministritë e linjës duhet të raportojnë shumë hollësi për konsultimet publike gjatë vitit. Ato duhet të raportojnë për konsultimet veç e veç, si dhe për aktivitetet e tyre vjetore të konsultimit.

Të dhënat që tani duhet të prodhohen janë të vështira për t'u mbledhur pasi ato burojnë nga raporte të ndryshme. Nuk është i mundshëm raportimi i automatizuar përmes platformës së konsultimeve online në internet.

Për më tepër, duhet të përgatiten dy raporte: një për ZKM dhe një për ZQM. Kjo mund të thjeshtohet në mënyrë që të përgatitet vetëm një raport.

***Rekomandimi 14: ZQM duhet të rivlerësojë kërkesat për raportim dhe duhet të përcaktojë se çfarë raporte dhe cilat të dhëna duhet të sigurohen nga ministritë e linjës.***

***Rekomandimi 15: Kur të ridizajnohet platforma e konsultimeve në internet, ZQM duhet të sigurojë që raportimi të bëhet në versionin e automatizuar sa më shumë që është e mundshme. Kjo i lejon administratës që të përqendrohet më shumë në përmbajtjen e konsultimit publik.***

### **Integrimi i të gjitha hapave të hartimit të legjislacionit dhe vendimmarrjes së qeverisë**

Procesi i konsultimit publik është një segment i rëndësishëm i procesit të vendimmarrjes për propozimet ligjore dhe të politikave. Aktualisht, administrata duhet të punojë me një sistem të vështirë, në të cilin versione të ndryshme të dokumenteve ndahen përmes postës elektronike. Nuk ka një platformë të përgjithshme digjitale që mbështet vendimmarrjen si të tillë.

ZQM, së bashku me faktorët e tjerë të rëndësishëm, duhet të vlerësojnë mundësitë për të zhvilluar sistemin e TI-së për menaxhimin e procesit të vendimmarrjes së qeverisë. Platforma e konsultimeve në internet duhet të jetë pjesë përbërëse e zhvillimit të një sistemi të tillë.

## Maqedonia e Veriut: ENER

Qeveria e Maqedonisë së Veriut zhvilloi platformën ENER që shërben si ndërfaqe mes administratës dhe qytetarëve. Shumë informata janë publikuar në këtë platformë dhe detyrimi për konsultim publik është një kërkesë që është futur në infrastrukturën digjitale për procesin e vendimmarrjes.

Burimi: <https://ener.gov.mk/Default.aspx>

## Komisioni Evropian: Decide

Komisioni Evropian ka investuar kohë dhe burime të konsiderueshme për digjitalizimin e procesit të tij të vendimmarrjes përmes zhvillimit të Decide. Të gjithë hapat e vendimmarrjes janë të integruar në këtë platformë digjitale, përfshirë përkthimin e dokumenteve përkatëse. Kjo e bën shumë më të lehtë menaxhimin e procesit të vendimmarrjes.

Burimi: [https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/strategic-plan-2016-2020-dg-sg\\_april2016\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/strategic-plan-2016-2020-dg-sg_april2016_en.pdf)

**Rekomandimi 16:** *ZQM duhet - në bashkëpunim me Zyrën Ligjore, Zyrën e Planifikimit Strategjik, Sekretarinë Mbështetëse të Qeverisë, Zyrën e Komisionarit për Gjuhë dhe organizata të tjera përkatëse, të vlerësojnë mundësinë për të zhvilluar një platformë digjitale që integron të gjitha kërkesat e vendimmarrjes. Sistemi TI mund të integrojë parakushtet, p.sh., që procesi i miratimit nuk mund të fillojë nëse nuk janë zhvilluar aktivitetet minimale të këshillimit të detyrueshëm. Platforma e konsultimeve në internet duhet të jetë një element i plotë në një sistem të tillë të TI.*

## Qasja në TI për koordinatorët për konsultim publik

Në vitin 2020, ndonjëherë ka pasur probleme me publikimin e dokumenteve në platformën e konsultimeve publike nga ana e koordinatorëve.

Është shumë e rëndësishme që koordinatorët të kenë qasje në platformë pa problem si nga zyra dhe nga shtëpia.

**Rekomandimi 17:** ZQM duhet të nxisë zhvillimin e një zgjidhjeje në mënyrë që të gjithë koordinatorët për konsultimin publik në ministritë e linjës të kenë qasje të plotë në platformën e konsultimit në internet nga vendet e tyre të punës.

**Rekomandimi 18:** ZQM duhet të kontrollojë nëse koordinatorët për konsultim publik në nivelin lokal gjithmonë kanë qasje në platformën e konsultimit në internet për të shmangur probleme të ngjashme që janë të pranishme në nivelin qendror.

## VIZIBILITETI I PLATFORMËS SË KONSULTIMEVE NË INTERNET

Ndonëse Platforma e konsultimeve në internet është shpalosur dhe është funksionale, ajo nuk është aq e njohur sa duhet për të rritur pjesëmarrjen në konsultimet publike dhe për të rritur numrin e përgjigjeve që pranohen.

Çështja e nivelit të ulët të pjesëmarrjes dhe e numrit të ulët të përgjigjeve duhet të trajtohen në dy mënyra.

Fillimisht, përmirësimet në platformën e konsultimeve në internet, siç u paraqit më sipër, pritet të lehtësojnë pjesëmarrjen në procesin e konsultimit.

Së dyti, promovimi i platformës së konsultimeve në internet dhe i konsultimeve të veçanta duhet të rriten në mënyrë që sa më shumë njerëz të jenë të vetëdijshëm për mundësitë që kanë për të kontribuar në konsultimet publike dhe për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes.

### **Krijimi i platformës së konsultimeve në internet si kanal i vetëm për dhënien e kontributit për palët e interesuara**

Disa palë të interesit ende parapëlqejnë të paraqesin komentet e tyre drejtpërdrejtë përmes postës elektronike në vend që të paraqesin sugjerimet e tyre zyrtarisht përmes platformës së konsultimit. Kjo duhet të ndryshojë për të treguar vlerën e shtuar të procesit të konsultimit përmes platformës në internet, meqë vetë parashtrësat u nxitën përmes publikimit të projekt propozimeve në platformën e konsultimeve në internet.

Në këtë aspekt mund të merren parasysh dy nivele të veprimtarisë.

Së pari, ZQM organizon takime me ministritë e linjës dhe shoqërinë civile për të trajtuar paraqitjen e kontributeve jashtë kanaleve zyrtare të konsultimit. Takimet e tilla mund të mbahen edhe me organizata ndërkombëtare.

Së dyti, ZQM mund të parashikojë një ndryshim në rregulloren për standardet minimale për konsultim publik në mënyrë që të gjitha parashtrirat që merren jashtë kanaleve zyrtare të konsultimit prapëseprapë merren parasysh në raportet për konsultimet e veçanta dhe që publikohen edhe në internet.

**Rekomandimi 19:** *ZQM duhet të organizojë takime në nivelin qendror me ministritë e linjës dhe OSHC-të për të inkurajuar përdorimin e platformës së konsultimeve në internet kur paraqesin komente për projekt propozimet (në vend që të përdorin kanale joformale).*

**Rekomandimi 20:** *ZQM duhet të organizojë takime në nivelin lokal me ministritë e linjës dhe OSHC-të për të inkurajuar përdorimin e platformës së konsultimeve në internet kur paraqesin komente për projekt propozimet (në vend që të përdorin kanale joformale).*

**Rekomandimi 21:** *ZQM duhet të merr parasysh ndryshimin e rregullores që mbulon konsultimin publik dhe që të bëjë të detyrueshme që paraqitja jozyrtare e komenteve të pasqyrohet në mënyrë transparente në raportet për konsultime.*

### **Promovimi i platformës së konsultimeve në internet**

Përgjithësisht, është fituar përshtypja se deri më tani përgjithësisht nuk ka qenë e mjaftueshme përhapja e informacionit për publikun dhe shpërndarja e informacionit tek OSHC-të në lidhje me ekzistimin e platformës së konsultimeve në internet dhe se si të marrin pjesë në konsultime.

Me përfshirjen e nivelit lokal në platformën për konsultime në internet, të gjitha proceset e vendimmarrjes qeveritare pritet që zyrtarisht të vazhdojnë përmes platformës. Kjo e bën më të rëndësishme marrjen parasysh të fushatave më të

gjera të informimit për t'i treguar mundësitë që ofron Platforma e konsultimeve në internet.

ZQM duhet të vlerësojë mundësitë për të intensifikuar aktivitetet e informimit në lidhje me promovimin e platformës së konsultimeve në internet. Është e rëndësishme që të organizohen aktivitete të tilla për një periudhë të zgjatur kohe dhe që të përsëriten aktivitete të caktuara në baza vjetore.

Ky informim duhet të përqendrohet gjithashtu në grupe specifike si media, akademikët dhe të rinjtë. Këto grupe të synuara duhet të identifikohen në bashkëpunim me shoqërinë civile.

***Rekomandimi 22: ZQM duhet të zhvillojë një plan shumëvjeçar të informimit dhe komunikimit për shpërndarjen e informacionit në lidhje me platformën e konsultimit në internet.***

***Rekomandimi 23: ZQM duhet të merr parasysh një fushatë të përgjithshme televizive dhe radiofonike për të inkurajuar qytetarët dhe bizneset që të marrin pjesë në konsultimet publike në platformën për konsultime në internet.***

### **Promovimi i konsultimeve të veçanta**

Konsultimet publike shpesh publikohen në platformën e konsultimit pa ndonjë njoftim paraprak. Një praktikë e tillë do të thotë që palët e interesuara mund të mos jenë në dijeni se kanë filluar konsultimet publike për një pjesë të caktuar të projekt-legjislacionit, duke rezultuar në më pak kohë për t'u përgatitur dhe për t'u përfshirë në konsultime.

Kur konsultimet publikohen në platformën e konsultimit në internet, ato nuk shpallen gjithmonë në kanalet e ndryshme të mediave (sociale) që po i përdorin administrata dhe vendimmarrësit.

Media lokale mund të jetë një bashkëbisedues i rëndësishëm me qëllim të informimit të publikut pasi që shumë njerëz ndjekin televizionet lokale. Përgjithësisht, vendimet transmetohen në televizione lokale, por, mund të transmetohen edhe njoftime për diskutime publike. Për më tepër, televizionet lokale mund t'i transmetojë diskutimet e tyre.

**Rekomandimi 24:** Ministritë e linjës dhe komunat duhet të jenë të detyruara që të shpallin fillimin e konsultimeve publike në internet, p.sh., përmes rrjeteve të tyre sociale në mënyrë që t'u sigurojnë palëve të interesit mundësinë që të përgatiten për pjesëmarrjen e tyre në konsultim.

**Rekomandimi 25:** ZQM duhet të marrë parasysh një vegëz automatike mes llogarisë së mediave sociale të ZQM dhe platformës së konsultimeve në internet në mënyrë që çdo konsultim i publikuar renditet automatikisht në burimin e saj. Përndryshe, llogaritë e mediave sociale për platformën e konsultimit në internet mund të krijohen që bëjnë të njëjtën gjë.

**Rekomandimi 26:** Praktika e promovimit të konsultimeve publike përmes kanaleve të mediave (sociale) të institucioneve qeveritare dhe vendimmarrësve përgjegjës duhet të integrohet në procesin e konsultimit publik dhe mundësisht edhe në standardet minimale për konsultim publik.

**Rekomandimi 27:** ZQM dhe MAPL duhet të vlerësojnë së bashku me komunat mundësitë për të angazhuar mediat lokale për promovimin e konsultimeve publike dhe ngjarjeve të konsultimit.

**Rekomandimi 28:** ZQM, në bashkëpunim me ministritë përkatëse të linjës dhe komunat, duhet të identifikojnë skedarë/raste të profilit të lartë për të cilat mund të organizohet procesi i konsultimit, p.sh., përfshirë konkurset për ese për nxënësit/studentët dhe ngjarjet e konsultimit në secilën komunë.

## **Përcjellje më e mirë e konsultimeve të mbyllura**

Mospranimi i informatave të plota apo të mjaftueshme për komentet e dhëna përmes konsultimeve publike mund të çojë në ngurrim të madh për njerëzit që të kalojnë kohën e tyre duke marrë pjesë në konsultime.

Në përgjithësi, njerëzit shohin se ka shumë pak shpjegime dhe komunikim pasi të mbyllet procesi i konsultimit. Çka është më e rëndësishme, nuk është e qartë se si janë marrë parasysh komentet.

Disa përmirësime të platformës në internet që mund të merren parasysh, si dhënia e përgjigjeve ndërsa konsultimi publik në internet është duke vazhduar, do ta trajtonin këtë çështje. Sidoqoftë, mund të ketë edhe aktivitete të tjera të cilat do të siguronin më shumë transparencë dhe të dhëna për atë se si janë marrë parasysh komentet e pranuar përmes konsultimeve publike dhe aktivitete të tjera të konsultimit.

**Rekomandimi 29:** *ZQM duhet të vlerësojë se si informatat kthyesë pas përmbylljes së konsultimeve mund të përmirësohen sipas kornizës aktuale ligjore. Pas konsultimeve publike mund të mbahen seminare në internet dhe ngjarje të tjera që organizohen lehtë, në mënyrë që të diskutohen parashtrësit dhe përgjigjet e administratës.*

**Rekomandimi 30:** *Kur të bëhet rishikimi i platformës së konsultimeve në internet dhe i rregullores që mbulon konsultimin publik, ZQM duhet të marrë parasysh kriteret shtesë për informatat kthyesë për të shtuar transparencën në lidhje me atë se si komentet u morën parasysh.*



## KORNIZA LIGJORE DHE ZBATUESE PËR KONSULTIME PUBLIKE

### Vlerësimi zyrtar i rregullores

Procesi që u nis nga ZQM me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë për të vlerësuar atë sesi mund të përmirësohen konsultimet publike ka nxjerrë në pah një numër të madh të çështjeve që duhet të trajtohen. Në disa fusha tashmë është e qartë se janë të nevojshme ndryshim-plotësimet në rregullore për standardet minimale për konsultim publik. Futja e karakteristikave të reja teknike në uebfaqe duhet të vazhdojë paralelisht me kërkesën ligjore për t'i përdorur këto.

Me një diskutim që pritet të mbahet për ndryshimet në rregulloren që mbulon konsultimin publik, ZQM duhet të konsiderojë nisjen e fazës zyrtare të vlerësimit ex-post në vitin 2021 për të pasur një bazë të fortë provash për ndryshimet në kërkesat/kriteret për konsultim publik. Një proces i tillë mund të kombinohet me prezantimin e veçorive dhe mundësive të reja në platformën për konsultime në internet.

Një proces i tillë do t'i mundësojë ZQM-së që të marrë parasysh aspektet që nuk janë diskutuar deri më tani në këtë raport, siç janë çështjet që lidhen me kohën minimale gjatë së cilës konsultimet publike janë të hapura për komente (2 javë) dhe nëse kjo është e mjaftueshme për palët e interesit që të japin përgjigje.

***Rekomandimi 31: ZQM duhet të merr parasysh nisjen e një vlerësimi zyrtar ex-post të rregullores për standardet minimale për konsultim publik në vitin 2021.***

### Përfshirja në fazën e hershme dhe konsultimi në vendimmarrje

Platforma e konsultimeve në internet përcakton konsultimin në një fazë të vonshme të procesit të vendimmarrjes. Ndonëse kjo siguron nivele të larta transparence dhe mundësi për të gjithë për t'u angazhuar në procesin e vendimmarrjes, në këtë rast ka një vlerë të shtuar nëse fokusi vendoset në përmirësimin dhe rritjen e angazhimit në fazën e hershme.

Më shumë punëtori me palët e interesuara duhet të organizohen në fazat e hershme të vendimmarrjes, përveç mbledhjes së detyrueshme publike në fillim të çdo procesi të vendimmarrjes. Kjo konsiderohet si një mënyrë më efektive për t'u angazhuar me organizata që kanë më pak kapacitete, pasi që ato do të jenë në gjendje të ofrojnë sugjerime të rëndësishme për procesin e mëtejshëm të vendimmarrjes.

**Rekomandimi 32:** *ZQM duhet të promovojë konsultimin me palët të interesit në fazën e hershme përveç mbledhjes publike që është tashmë e detyrueshme. Në lidhje me rishikimin e mundshëm të rregullores për standardet minimale për konsultim publik, përfshirja e tillë në fazën e hershme të palëve të interesit mund të mishërohet më shumë në kornizën ligjore.*

### **Zbatimi më i rreptë i standardeve minimale**

Me sa duket zbatimi i standardeve minimale për konsultim publik nuk është siguruar plotësisht. Konsultimet publike nuk organizohen çdo herë dhe kur ato organizohen, ato nuk janë gjithnjë në përputhje me kërkesat minimale.

Ndonëse kjo çështje mund të zbatohet vetëm në nivelin qendror, zhvillimi i saj në nivel lokal duhet të shmanget.

#### **Niveli qendror: kërkesa më të rrepta për miratim**

Ekzistojnë disa probleme në lidhje me zbatimin e standardeve minimale për kohëzgjatjen e konsultimeve publike, ndërsa ligjet shpesh marrin shumë kohë për t'u miratuar zyrtarisht. Kërkesa për t'u konsultuar dhe afatet minimale kohore duhet të respektohen gjithmonë, por kjo nuk është duket ndodhur. Këto afate tashmë janë të shkurta dhe nuk duhet të reduktohen edhe më tej. Përveç kësaj, shpesh procesi i hartimit të ligjeve brenda administratës para se një projektligj të miratohet nga qeveria dhe të dërgohet në kuvend është shumë i gjatë. Kjo nuk shkon mirë me shkurtimin e periudhave zyrtare të konsultimit.

Gjithashtu, kur dorëzohen komente që nuk merren parasysh, ministritë e linjës nuk e bëjnë gjithmonë të qartë se pse disa ide nuk merren parasysh. Kjo çështje mund të trajtohet shpejt pasi që rregullorja veçse shpjegon se si duhet të bëhet kjo gjë në praktikë. Kjo është një çështje që duhet të zbatohet në mënyrë sa më sistematike.

**Rekomandimi 33:** *ZQM duhet të sigurojë se në rishikimin e ardhshëm të Rregullores së Punës të Qeverisë, kërkesat minimale për konsultim publik duhet të respektohen plotësisht përpara se një propozim të miratohet nga Qeveria ose Ministria (për akte të caktuara nënligjore).*

**Rekomandimi 34:** Kur të zhvillohet versioni tjetër i platformës së konsultimeve në internet, ZQM duhet të sigurojë që platforma nuk u mundëson organizatave që të shmangen nga standardet minimale nëse kjo nuk lejohet në mënyrë të qartë.

Niveli lokal: kartela e vlerësimit të rezultatit

Komunat vetëm kohët e fundit janë integruar në platformën e konsultimit në internet dhe kanë filluar që të paraqesin propozimin për konsultim publik. Mund të pritet që komunat do të përballen me sfida të ngjashme si niveli qendror kur u fut në përdorim konsultimi publik. Përveç kësaj, konteksti lokal mund të zbulojë faktorë të tjerë ndërlikues që ende nuk janë marrë parasysh.

MAPL monitoron performancën e komunave, monitorim i cili tregon se nuk ka progres në të gjithë Kosovën kur bëhet fjalë për komunat. Në lidhje me konsultimet publike, për shembull, nuk janë përfunduar ende detyrat praktike dhe që janë të lehta për t'u realizuar. Në fakt, shumë uebfaqe të komunave të ndryshme ende nuk e kanë të vendosur vegëzën për platformën e konsultimeve në internet.

Koordinatorët për konsultim publik në nivelin lokal ende nuk janë caktuar në çdo komunë. Udhëzimi administrativ për konsultim publik në nivelin lokal nuk është zbatuar ende plotësisht. Udhëzimi praktik është përgatitur dhe nga aspekti teknik niveli lokal është i integruar në platformë, por vetë procesi dhe shumë kërkesa praktike mbeten për t'u zbatuar.

**Rekomandimi 35:** ZQM dhe MAPL duhet të zhvillojnë një kartelë të vlerësimit të rezultatit në nivel lokal për konsultim publik për të treguar se deri në çfarë shkalle komunat kanë zbatuar kërkesat praktike që kanë të bëjnë me konsultimin publik. Kartelat e vlerësimit të rezultatit duhet të publikohen dhe mund të jenë të lidhura me sistemin e granteve që MAPL ka krijuar për komunat.

### **Kanale dhe metodologji të shumëfishta të konsultimit**

Platforma e konsultimeve në internet është një komponent jetik në qasjen e konsultimit publik në Kosovë. Në të njëjtën kohë, administrata duhet të jetë më kreative në lidhje me mënyrat se si ajo organizon dhe zbaton procesin e konsultimit publik, në veçanti për të arritur grupe specifike të synuara dhe për ta bërë më të lehtë pjesëmarrjen në konsultimin publik.

Administrata duhet të vlerësojë sesi mund të shkojë përtej mënyrave standarde të rregulluara që pasqyrohen në rregulloren që rregullon konsultimin publik. Për shumë kë, dorëzimi i komenteve përmes platformës së konsultimeve në internet, në modelin aktual, është proces i rëndë dhe është barrë e lartë mbi pjesëmarrjen.

Administrata duhet të gjej metoda shtesë për të angazhuar qytetarët dhe tashmë shumë prej tyre janë në dispozicion. Gjithashtu, duhet të ketë qasje më të mirë për shpërndarjen dhe informimin për konsultimet e veçanta. Teknologjia për ta bërë këtë është tashmë në dispozicion dhe sfida kryesore është identifikimi se cilat teknologji të tilla mund të zbatohen në mënyrë të lehtë dhe efektive.

Përzgjedhja e metodave të konsultimit duhet të bazohet në atë se shumë organizata nuk kanë burime ose kapacitete për të dhënë komente për një projektligj ose dokument tjetër të gjatë pasi që nuk e kanë ekspertizën e hollësishme të specializuar për këtë. Për më tepër, shumë njerëz nuk janë të gatshëm ose të aftë që të japin komentet për një dokument të gjatë dhe të ndërlikuar siç përcaktohet aktualisht.

**Rekomandimi 36:** *ZQM duhet të vlerësojë se cilat metoda alternative të konsultimit mund të përdoren për të plotësuar platformën e konsultimit publik. Zbatimi i mundshëm i këtyre metodave duhet të integrohet në standardet minimale për konsultim publik.*

**Rekomandimi 37:** *ZQM duhet - në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse të linjës ose komunën - të zgjedhë një numër skedarësh me të cilat do të testohen metodat dhe qasjet e reja të konsultimit për të parë vlerën e tyre të shtuar potenciale.*

**Rekomandimi 38:** *ZQM duhet, në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe komunat, të vlerësojë nëse është e mundur që logjikisht të paraqiten disa elemente të një propozimi që tashmë është në konsultim publik, mundësisht përmes platformës së konsultimeve në internet. Për shembull, platforma mund të integrojë mundësinë për të kryer anketa dhe sondazhe ndër organizatat e regjistruara.*

## ZHVILLIMI I KAPACITETEVE

Është me rëndësi të përcaktohet një proces që synon forcimin e kapaciteteve të të gjitha institucioneve relevante në nivelin qendror dhe lokal, si dhe të organizatave të shoqërisë civile, grupeve profesionale dhe aktorëve të tjerë.

### Kapacitetet e ZQM dhe MAPL

ZQM dhe MAPL luajnë rol të veçanta në proceset e konsultimit publik. Ata janë nismëtarët dhe shtytësit e reformave dhe prandaj luajnë një rol të rëndësishëm për promovimin e të praktikave të konsultimit publik dhe për sigurimin e transparencës për të marrë se deri në çfarë shkalle është realizuar përvetësimi i tillë.

Kapacitetet e ZQM dhe MAPL duhet të jenë në përputhje me detyrën që duhet ta kryejnë. Kjo vlen për numrin e burimeve njerëzore që nevojiten dhe gatishmërinë e personelit të përfshirë në reformat që kanë të bëjnë me konsultimin publik.

ZQM dhe MAPL duhet të vlerësojnë nevojat e tyre për një periudhë afatmesme për të siguruar që përmirësimet në lidhje me platformën e konsultimit në internet, rregullimet në procesin e konsultimit (në veçanti përfshirjen në fazë të hershme të palëve të interesit), zbatimin e procesit të konsultimit në nivelin lokal, përditësimi i rregullores që mbulon konsultimin publik, përvetësimi i metodave të reja të konsultimit dhe rregullimi i standardeve minimale për konsultim publik mund të kryhen në mënyrë efektive. Të dy organizatat duhet të marrin parasysh kombinimin e rekrutimit të personelit, trajnimit të personelit, asistencën teknike dhe mbështetjen e donatorëve në lidhje me konsultimin publik.

Një perspektivë e tillë afatmesme e nevojave duhet të lidhet me kornizën e politikave strategjike për përmirësimin e procesit të konsultimit publik në të ardhmen.

***Rekomandimi 39: ZQM dhe MAPL duhet të kryejnë një vlerësim afatmesëm të nevojave përkitazi me personelin, trajnimit, asistencën teknike dhe mbështetjen nga donatorët.***

**Rekomandimi 40:** ZQM duhet të merr parasysh përditësimin e kornizës së politikave strategjike që kanë të bëjnë me konsultimet publike për të nxitur përmirësimin e konsultimeve publike edhe më tej në perspektivën politike për Kosovën. Në këtë kontekst, OZHQ-ve mund t'u kushtohet vëmendje më e madhe.

### **Niveli qendror dhe lokal: administrata**

Me përfundimin e trajnimit për trajnerë dhe certifikimin e trajnerëve për konsultime publike, Kosova ka kapacitete në dispozicion për ofrimin e trajnimeve për këtë temë. Këto duhet të përdoren në mënyrë pro aktive dhe ambicioze. ZQM duhet të përcaktojë objektiva të qarta për mbajtjen e trajnimit, veçanërisht në lidhje me numrin e zyrtarëve publik të trajnuar. Së bashku me IKAP, ZQM duhet të vlerësojë vlerën e moduleve të trajnimit në internet për konsultim publik për të plotësuar trajnimet me prani fizike. Kurdo që është e nevojshme, duhet të zhvillohen module specifike të trajnimit në internet për nivelin lokal.

Konsultimi publik varet nga zbatimi i kërkesave/kritereve të konsultimit, por gjithashtu edhe nga cilësia e materialeve të konsultimit dhe gjuha që përdoret. Shumë vëzhgues arrijnë në përfundimin se aftësitë për të shkruar brenda administratës kanë shumë nevojë për përmirësim. ZQM duhet të vlerësojë me IKAP mundësinë për të hapur trajnime të specializuara që kanë të bëjnë me hartimin e politikave.

**Rekomandimi 41:** ZQM duhet të vendosë objektiva të qarta trajnimi për zyrtarët publikë në nivelin qendror dhe atë lokal të cilët trajnohen për konsultimin publik dhe duhet të sigurojë informim të shpejtë brenda administratës përmes trajnimit.

**Rekomandimi 42:** ZQM, në bashkëpunim me IKAP, duhet të shqyrtojë nëse mund të zhvillohen modulet e trajnimit në internet për konsultim publik.

**Rekomandimi 43:** Së bashku me MAPL dhe IKAP, ZQM duhet të vlerësojë nëse modulet e trajnimit në internet duhet të zhvillohen enkas për nivelin lokal.

**Rekomandimi 44:** ZQM dhe IKAP duhet të vlerësojnë mundësinë për të zhvilluar dhe për të mbajtur trajnime në lidhje me hartimin e politikave në mënyrë që të përmirësojnë cilësinë e dokumenteve të konsultimit. Kjo mund të plotësohet gjithashtu me një trajnim për trajnerë për këtë temë.

### **OSHC në nivel qendror dhe lokal**

Ndonëse OSHC-të pritet të luajnë rol jetik në zhvillimin e politikave dhe ligj bërje përmes procesit të konsultimeve publike, ato shpesh nuk kanë burime njerëzore apo kapacitete për të marrë pjesë në mënyrë efektive në aktivitetet e konsultimit. Kjo vlen posaçërisht në lidhje me konsultimin në fazën e fundit gjatë vendimmarrjes përmes platformës së konsultimeve në internet.

Ndërsa është e qartë se nevojitet zhvillim shtesë i kapaciteteve për OSHC, nuk mund të përcaktohet ende se çfarë lloj mbështetje do të ishte më e përshtatshme për zhvillimin e kapaciteteve.

**Rekomandimi 45:** ZQM dhe MAPL duhet të vlerësojnë nëse mund të zhvillojnë programe ose aktivitete mbështetëse për OSHC në lidhje me promovimin e përvetësimit dhe pjesëmarrjes në konsultimet publike në nivelin lokal duke filluar në vitin 2021.

**Rekomandimi 46:** ZQM, së bashku me organizatën përgjegjëse për koordinimin e donatorëve, duhet të angazhohen me komunitetin e donatorëve për të vlerësuar mundësitë që ata të mbështesin në një mënyrë më efektive zhvillimin e kapaciteteve të OJQ-ve për pjesëmarrjen në konsultimet publike.

**Rekomandimi 47:** ZQM duhet të ndërmerr një analizë të kapaciteteve të OSHC-ve në nivel qendror dhe lokal (mundësisht në çdo komunë). Në bazë të kësaj analize, ZQM dhe MAPL mund të përcaktojnë modalitetet më të mira të mbështetjes për OSHC-të në periudhën afatmesme.





# **Kornizë për përmirësimin e zbatimit të standardeve minimale për konsultimet publike 2021-2025**

*Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër  
të Zyrës së Kryeministrit*